

URDHËR
Nr. 778, datë 29.12.2023

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
KROACISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Kroacisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	* Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Osjecko-Baranjska	Beli Manastir*	
2	Brodsko-Posavska	Oriovac*	
3	Grad Zagreb	Stupnik*	
4	Karlovacka	Karlovac*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 487, datë 24.10.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Kroacisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj